



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

PROJEKT VENDIM

NR \_\_\_\_ DATË. \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË PYJEVE BASHKIAK  
TË EKONOMISË PYJORE BARMASH

**Në zbatim Ligjet:**

Në zbatim të Ligjit nr 57/2020 "Per Pyjet " te datës 30.04.2020, V.K.Ministrave nr 433 dt 08.06.2016 " Për transferimin në pronësi të pyjeve dhe kullotave " V.K.M nr 398 dt 15.05.2020 për disa ndryshime. Udhëzimit nr 3 dt 22.06.2007 " Mbi procedurat e miratimit të planeve të mbareshtrimit të pyjeve dhe kullotave " si dhe Ligjin nr 139 /2015 " Per veteqeverisjen vendore". Sipas Planit të Menaxhimit të hartuar nga Subjekti "ETTA CONS" shpk, për Ekonomine Pyjore Barmash e financuar nga Bashkia Kolonje.

I propozojme Këshillit Bashkiak miratimin e tij.

I propozojmë Këshillit të Bashkisë:

- i. Te shqyrtoje kërkesën për Miratimin e Planit të Menaxhimit :

*Miratim paraprak të Planit të Menaxhimit të Ekonomisë Pyjore Barmash të hartuar nga Subjekti "ETTA CONS" shpk, sipas Kontrate Prokurimi Sherbime Nr. 7, date 01.09.2025, financuar nga Bashkia Kolonje.*

Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve, Parqeve Dhe Rekreacionit dhe Kryetari i Bashkisë.

2. Ky projekt- vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015 date 17.12.2015 neni 55, pika 6.

Konceptoi

Ing. Ervin ÇUKA

Pranoi

Petro KRISTO

NE MUNGESË DHE ME URDHER  
NEN/KRYETAR

Petro RISTO

KRYETARI

Erion ISAI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

Nr. 2092 prot.

Ersekë më 30. 8. 2026

RELACION SHPJEGUES

I EKONOMISE PYJORE BARMASH

Mbarështimi i pyjeve është planifikimi afatgjatë për fondin pyjor, i cili në rastin konkret është bërë në bazë të kriterëve të caktuara për grumbullimin e informacionit për gjendjen faktike dhe përcaktimin e objektivave dhe masave të nevojshme, në funksion të statusit të dhënë, me synim përmbushjen e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale, duke zbatuar dhe harmonizuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe shumë funksional me nevojat e administruesve, pronarëve privat dhe përdoruesve të tyre. Plani i Mbarështimit të Ekonomisë pyjore Barmash, synon që të merren në konsideratë të gjithë faktorët që lidhen direkt ose indirekt ndërmjet tyre - popullata lokale, faktorët ekologjik dhe tokësore, administrimi i pyjeve dhe kullotave, ekoturizmi, interesi që ofron pylli, blegtorët etj., pa harruar shërbimet në ekosistem që pylli ofron, të tilla si;

- ✓ kufizimin dhe mbrojtjen nga erozioni, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujrave.
- ✓ ruajtjen e natyrës dhe qëndrueshmërinë e resurseve.
- ✓ mbrojtja e tokave bujqësore.
- ✓ mbrojtjen e zonave urbane dhe infrastrukturës, etj. Nga ana tjetër pylli përmbush edhe funksione të tjera si;
- ✓ plotësimi i nevojave me material drusor.
- ✓ bazë ushqimore për blegtorinë.
- ✓ si dhe një gamë e madhe të prodhimeve të dyta pyjore. Përdorimi dhe përftimi i të cilave duhet bërë nëpërmjet një zhvillimi të qëndrueshëm të pyjeve.

Pyjet sigurojnë dhe garantojnë mbrojtjen e ekosistemeve natyrore, habitateve dhe biotopeve, përmirësimin e peisazhit rural dhe mbrojtja e biodiversitetit, përbën një drejtim të rëndësishëm të projektit dhe zgjerimi i këtyre zonave do të jetë në qendër të objektivave të veçantë.

Gjithashtu vend të veçantë zë harmonizimi i interesave të komunitetit dhe të pjesëmarrësve të tjerë veprues në territorin e kësaj ekonomie pyjore, në përputhje me mundësinë prodhuese aktuale dhe potenciale të grumbujve pyjor. Ekonomia pyjore Barmash shtrihet në territorin e Bashkisë Kolonje, në territorin e kësaj ekonomie ndodhen 6 fshatra konkretisht fshati Shalës, fshati Gozhdarazhdë, fshati Sanjollas, fshati Barmash, fshati Leshnjë, Fshati Arëz. Popullsia totale e këtyre fshatrave 150 banorë, me 60 familje dhe rreth 102 krahë aktive pune(që jetojnë aktualisht). Popullsia e këtyre fshatrave ka një nivel të lartë emigrimi jashtë vendit por edhe migrim brenda vendit kryesisht drejt qytetit Tiranë. Grumbujt pyjorë të kësaj ekonomie (te propozuar) qeverisen si më poshtë:

- ✓ Pyjet trungishte zënë 634.4 ha ose 18.6% të sipërfaqes pyjore.
- ✓ Trungishte e paregullt zënë 42.6 ha ose 1.3 % të sipërfaqes pyjore.
- ✓ Pyjet cungishte zënë 2672.1 ha ose 78.4 % të sipërfaqes pyjore.
- ✓ Pyjet shkurre zënë 57.5 ha ose 1.7 % të sipërfaqes pyjore.

Përdorimi i territorit (i propozuar) si më poshtë: sipërfaqja totale e ekonomise eshte 4661 ha

- ✓ Pyll 3406.6 ha
- ✓ Sipërfaqe me bimësi pyjore 189.7 ha
- ✓ Kullotë, livadhe 433.5 ha
- ✓ Joproductive 18.5 ha

Në aspektin e organizimit natyror kjo ekonomi paraqet një ndërthurje të mirë të elementeve ekstensive dhe intensive të burimeve dhe resurseve pyje, kullota, sipërfaqe inproduktive, djerr, fond bujqësor, ujra, zona urbane me florë dhe faune të larmishme dhe mbi të gjitha faktori njeri si përfitues, përdorues i këtyre burimeve. Gjithsesi, kërkohet një edukim i vazhdueshëm dhe menaxhim afatgjatë e i qëndrueshëm për ti vënë në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetesës për komunitetet dhe grupet e interesit në zone, duke siguruar punësim dhe sigurim të ardhurash. Problematika kryesore në zonë ka të bëjë me migrimin dhe emigrimin e brezit të ri, burime të kufizuara financiare për familjet, si dhe menaxhimi jo i qëndrueshëm i burimeve natyrore. Detyrat kryesore për 10 vjeçarën e ardhshëm në zbatim të këtij Plani Mbarështimi rrjedhin nga programi strategjik i Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e sektorit pyjeve e kullotave në harmoni të plotë me programet e Bashkisë Kolonjë.

Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështimit është vlerësimi i gjendjes aktuale të fondit pyjor/kullor sipas formës përdorimit, grumbullimit e të dhënave rishikimi, përpunimi, analizimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me vegjetacionin aktual dhe mundësit potenciale të tipeve të grumbujve pyjorë dhe tipeve të kullotave. Në objektivat e këtij plani mbarështimi një vend të rëndësishëm zë qëllimi primar "sigurimi i një mbarështimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional i pyjeve/kullotave pa prishur ekuilibrin biologjik". Gjithashtu, ky plan mbarështimi do të garantojë përdorimin racional të burimeve natyrore pyjore dhe kullosore, që të kontribuojnë në cilësinë e jetesës në zonën rurale dhe jo vetëm

Ekonomia pyjore Barmash shtrihet në territorin e bashkisë Kolonje dhe aktualisht administrohet nga kjo bashki, dikur administrohej nga DSHP Kolonje. Plani i mbarështimit është i vlefshëm për periudhën kohore nga 2026 deri 2035. Plani i ri i mbarështimit hartohet sepse nuk ka patur plan të mirefillte mbarështimi të integruar, gjithashtu plani i vjetër i mbarështimit është hartuar në vitin 1985 dhe ka qënë i vlefshëm deri 1994. Një tjetër arsye është se bashkia Kolonje ka siguruar mbështetje financiare për hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në territorin e saj. Ekonomia pyjore është me të njëjtin emër dhe sipas planit të vitit 1985 ka patur një sipërfaqe totale prej 5607.75 ha, ndërsa me planin e ri të viti 2026 dhe ndarjen e re territoriale kjo sipërfaqe arrin në 4661 ha. (ketu duhen llogaritur edhe parcelat e zonave të mbrojtura) si dhe (heqja e parcelave që ka marrë private) Përshkrimi i përgjithshëm i ekonomisë ka për qëllim njohjen dhe evidentimin e problemeve teknike dhe sociale të mprehta të zonës ku do të kryhet mbarështimi, në mënyrë që të gjejnë pasqyrim në objektivat e mbarështimit për të ardhmen. Mbarështimi i grumbujve pyjor të ekonomisë pyjore Barmash ka synuar dhe synon që nëpërmjet zbatimit të një silvikulture natyralistike të garantojë stukturën shumëmoshare të grumbujve, të ruaj biodiversitetin në përputhje me karakteristikat ekologjike stacionale, të sigurojë vijueshmërinë e prodhimeve të pyllit dhe veçanërisht ripërtëritjen natyrore dhe shumëfunksione të grumbujve pyjorë

## Specialisti I Kadastres dhe Kullotave

Ing. Ervin ÇUKA